



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.92 dt.03.07.1998

**PER
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN MAJ 1998.**

Në bazë të Ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshimeve të tij si dhe të vendimeve dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin, projekt vendimin, borderotë dhe proces verbalin e mbajtur nga Komisioni Ekonomik dhe i Përkrahjes Sociale me dt.26.06.1998 për dhënie e ndihmës ekonomike për muajin maj 1998.

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **9888** familje me një fond prej **31.032.181 lekë**. Për çdo njësi administrative si vijon :

Nj.A.	FAMILJE	FONDI	Nj.A.	FAMILJE	FONDI
1.	876	2.739.393	7.	716	2.264.357
2.	893	2.662.595	8.	690	2.123.597
3.	823	2.578.133	9.	802	2.514.085
4.	1.227	3.914.485	10.	550	1.613.982

5.	1.123	3.558.148	11.	984	3.291.288
6.	1.204	3.772.118			
Gjithsej				9.888	31.032.181

2. Të miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje sipas relacionit.
3. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike **287 familje** sipas listave përkatëse në relacion.
4. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike : Rudina Dushku, Nj.A.1, Dhurata Halili, Adnand Abazaj, Lorenc Bakalli, Nj.A.5, Gëzim Kodra, Nj.A.7, për mostërheqje lekësh në afat dhe Ilir Heshta Nj.A.11, për mosparaqitje.
5. Të rihyjnë në skemën e ndihmës ekonomike **137 familje** sipas listës përkatëse në relacion. Familja e Fatmir Hamiti të mos rifutet në skemën e ndihmës ekonomike Nj.A.11.
6. Të trajtohen me ndihmë ekonomike në nivelin maksimal për familjet me 1 antar Eftali Qose Nj.A.7 dhe Liljana Kaba Nj.A.8.
7. Të trajtohet me ndihmë ekonomike si rast i veçantë për 6 muaj Qemal Tola Nj.A.3.
8. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për paaftësi **1798 persona** me aftësi të kufizuara dhe **153 persona** për kujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar me një fond gjithsej prej **6.455.490 lekë**.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Jashtme (Sektori i Mbrojtjes Shoqërore), Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe administratoret shoqërore, ekonomistët dhe arshivistë protokollistët e njërive administrative.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI